



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 4, dt. 30. 01. 2015

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 30. 01. 2015, pasi shqyrtoi problematikën e dalë gjatë zbatimit të punimeve në Kupolën e Kishës së Ristozit, Mborje, Korçë,

VENDOSI:

1. Të hiqet këmisha dhe brezi unazor i betonit në Kupolën e Kishës duke bërë më parë përforcimet konstruktive përkatëse.
2. Naosi të mbulohet me tjegulla bizantine si origjinalet e gjetura gjatë sondazheve.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI